



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**NOTER DENISA ÇELA
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 10,
RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA
NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA
NR.7
TEL: 0694058103**

DEGA VENDORE TIRANË

REVOKIM AKTESH E TË TJERA

(ZGJIDHJE KONTRATE)

Nr. repertori: 2739

Nr. koleksioni: 532

Tirane më 25/07/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053750060326403



ZGJIDHJE E KONTRATËS SË UZUFUKTIT

Sot, më datë 25 korrik 2022 (dymije e njezete e dy), para meje Notere DENISA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 10, RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA NR.7, u paraqit personalisht:

PRONARI

Përparim Kalo, atësia Nevruz, amësia Mejdije, shtetas shqiptar, lindur në Kuçovë dhe banues në Tiranë me adresë Bajram Curri, Nd. 1835, H. 6, Ap. 45, Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë, lindur më 12.12.1957, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 0333736794 dhe me nr. personal F71212078J.

UZUFUKTARI

Adi Brovina, atësia Kujtim, amësia Ana, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë me adresë Pjetër Bogdani, Nd. 13, H. 10, Ap. 24, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, lindur më 01.05.1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 035484921 dhe nr. personal I40501090D.

Pronari dhe Uzufuktari do të quhen më poshtë "Palë" ose bashkërisht "Palët".

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 868-876 e vijues i tij, ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 62, pika 1, gërma "II", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Zgjidhjes së Kontratës së Uzifruktit, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE :

- (A) Përparim Kalo është pronar i kuotave në shoqërinë KALO & ASSOCIATES, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare e Biznesit me numrin unik të identifikimit (NUIS) K31910009D, me seli në adresën, Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr. 27, Kati 5, Njësia bashkiake nr. 10, Tiranë ("Shoqëria") dhe ka në pronësi 69 për qind të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë;
- (B) Me Dekretin nr. 11882, datë 23.12.2020 të Presidentit të Republikës ai është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe sipas nenit 33 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, qenia ortak sjell papërshtatshmëri me emërimin si Gjyqtar dhe si rrjedhojë duhet të mos zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë kapitali në shoqëri tregtare, të çfarëdo forme;
- (C) Nëpërmjet Kontratës së Uzufuktit Nr. 12 Rep., Nr. 3 Kol., datë 05.01.2021 Z. Përparim Kalo ka vendosur krijimin e të drejtave të uzufuktit mbi kuotat e zotëruara prej tij në Shoqëri në favor të Eni Kalo sipas kushteve të përcaktuara në atë marrëveshje.
- (D) Në vijim të takimeve me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe mbi bazën e nenit 35 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005



“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Eni Kalo konsiderohet “person i lidhur me zyrtarin” dhe mbajtja aktive e kuotave në Shoqëri sjell gjithashtu konflikt interesi në interpretim të ligjit të mësipërm dhe si rrjedhojë ajo nuk duhet të zotërohet në mënyrë aktive, aksione ose pjesë kapitali në shoqëri tregtare, të çfarëdo forme.

- (E) Si rrjedhojë, me anë të Kontratës Nr. 225 Rep., Nr. 51 Kol., datë 22.1.2021, Eni Kalo ka kaluar Kontratën e Uzufruktit Nr. 12 Rep., Nr. 3 Kol., datë 05.01.2021, e ndryshuar, (“**Kontrata**”) dhe ka transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet në favor të Adi Brovina.

Palët kërkojnë të zgjidhin Kontratën e Uzufruktit Nr. 12 Rep., Nr. 3 Kol., datë 05.01.2021, e ndryshuar, dhe bien dakort si me poshte vijon:

Palët bien dakord të zgjidhin me marrëveshje Kontratën me efekt nga data e nënshkrimit.

Pronari do të zëvendësojë Uzufruktarin me të drejta të plota në të gjitha vendimet e Shoqërisë që merren pas datës së hyrjes në fuqi të zgjidhjes si më sipër dhe do të ushtrojë të drejtat e votës të lidhura me kuotën që përfaqeson 69% të kapitalit të Shoqërisë. Gjithashtu, të gjitha shpërndarjet që do të vendosen pas datës së hyrjes në fuqi të zgjidhjes si më sipër, pavarësisht periudhës të cilës i përkasin, do t’i takojnë Pronarit.

Zgjidhja e Kontratës do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe do të hiqen të gjitha kufizimet e lidhura me kuotën e Pronarit si dhe në çdo autoritet tjetër publik që kërkohet.

Zgjidhja e kontratës, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PRONARI

Përparim Kalo

UZUFRUKTARI

Adi Brovina

NOTERE

DENISA ÇELA